

## GJASIMET E KRYEPERSONAZHIT TË ROMANIT „PSE” TË STERJO SPASSES ME LETËRSINË ITALIANE

Shpresa MEMEDI<sup>1</sup>

### ABSTRAKT

Në këtë studim shkencor do të përpiqem të gjejë gjasimet e mundshme të kryepersonazhit Gjon Zaveri në romanin „Pse” të Sterjo Spasses me letërsinë italiane. Nga lista e poetëve dhe mendimtarëve italian që i gjasojnë mendimeve të personazhit kryesor Gjon Zaveri ndaj pikëpamjeve filozofike dhe mohimeve të jetës, pesimizmit dhe nihilizmit, dëshira e madhe për të paarrishmen janë: Giacomo Leopardi, Hugo Dosoglio, Boccaccio të cilën vetë shkrimtari Sterjo Spasse e përmend në romanin e tij, me veprën “Decameron”. Gjasimi me këta shkrimtarë do të jetë në raport me personazhin kryesor, krahasuar me mendimet e poetëve dhe pikëpamjet e tyre për jetën në përgjithësi. Poezia e këtyre shkrimtareve përqëndrohet në arratisjen nga jeta reale në disa raste ashtu siç bën ai, personazhi kryesor i romanit, duke ikur nga realiteti sepse nuk i përshtatet dot asaj bote të madhe, botës së ngjarjeve të mëdha, botës së idealeve masive të ekzaltimit, rendit shoqëror, aludim për shpresa të mëdha etj.

**Fjalët çelës:** Romani „Pse”, Giacomo Leopardi, Hugo Dosoglio, Boccaccio, Guido Gozzano.

Hezitimet e Gozzanos për botën që e rrethon dhe për veten e tij pajtohen me bindjet e Gjon Zaverit kur bëhet fjalë për njëmendësinë e ushqyer nga bota irracionale. Sepse vetminë që Gjoni adhuron, adhuron edhe Guido Gozzano duke u izoluar nga bota, ndaj dhe poezia e tij është në pjesën më të madhe një bisedë (shkëmbim mendimesh). Si shembull do të citoj një strofë nga poezia e Guido Gozzanos ku thotë :

„ Unë qesh i lënë në vetmi

*O qiell, o tokë, o det*

*Filloj të dyshoj!*

*Jetoj apo nuk jetoj!”*

Nënkuptohet se vargu i strofës së mësipërme “*Jetoj apo nuk jetoj*”, pajtohet plotësisht me një mendim të Gjonit ku thotë :

„*O jetë, o vdekje .....*

*Ose jam... ose s’jam,,(Pse,101)*

Në vazhdim të studimit shkencor nga citimi që vijon mund të vërtetojmë me shumë siguri ndikimin e dukshëm të Dante Alegierit në romanin "Pse" të Sterjo Spasses. Shkrimtari Dante në komedinë *hyjnore* në veprën „*Ferri*”, i rradhiti njerëzit sipas mëkateve që i kanë bërë në këtë botë dhe i vendos gjithmonë në katranin më të cekët ose më të thellë, sipas sasisë së mëkateve që i kanë bërë përmes rrugëtimit jetësorë.

Është e njëjta gjë me Gjon Zaverin, kur në ëndërr ose halucinacione, në një fushë të gjërë, ai takon një hije të madhe të një njeriu që mban një shpatë të madhe në krahë, kjo hije me shpatë masive në krahë personifikon vdekjen. Në fushën e pafund plot varre e kocka njerëzish, skeleti i madh i drejtohet Zaverit me urdhërin:

"Hej, pusho, pusho, djalosh!" Nuk dua duel me ty, rri pak larg meje. Po i shikon këto?  
Të gjithë ata i solli kjo shpatë këtu: Sokrati, Aristoteli, Cezari, Hugo, i keni të gjitha këtu.  
Unë kam një urdhër dhe nuk mund t'i shpëtoj urdhërit të tij. Një varr masiv i gjithë botës  
... dhe një shpirt?

"A e shikon atë manushaqe, atë kështjellë, atë gjemb, ato shkurre, pastaj mendo për mua  
dhe për shpirtin tënd..."

- Dhe Gjençi, një nga miqtë e mi ... zonja P ... një nga shoqet e mia, ku janë dhe çfarë  
kanë : gjemba apo manushaqe? E pyes pak me frikë.

"Zonja P... Aty pranë është një gjemb i **katranosur** dhe Gjençi po ashtu".

"Por pse është kështu?" - e pyes përsëri.

Pasi që Gjençi e tradhëtoi bashkëshorten tradhëtare, dhe zonja P ... e tradhëtoi  
bashkëshortin "(Pse, fq.99 / 100)

Përafërsisht e njëjta renditje ndodh si te „Komedia Hyjnore” e *Dante Alegierit*, por  
stigmatizimi është me mjete të tjera.

**Dekameroni** i Boccaccios <sup>381</sup>(një shkrimtar italian, udhërefyës i Rilindjes - një  
bashkëkohës i Dantes dhe Petrarkës) - i dërguar për Gjonin nga Italia nëpërmjet një miku,  
nuk ishte pa qëllim. Shkrimtari e bën këtë dërgesë për Gjonin me të vetmin qëllim për të  
ndryshuar mendimet arrogante të Gjonit ndaj botës femërore.

Por çdo përpjekje mbetet vetëm **kotësi**. Antifeminizmi është i rrënjosur thellë në  
njëmendësinë e tij si një dhimbje që nuk shërohet nga asnjë ilaç në këtë botë.

**Pesimizmi dhe nihilizmi, melankolia dhe apatia**, pakënaqësia dhe dhimbja  
shpirtërore, mohimi i të gjitha vlerave jetësore, nuk janë vetëm përvoja personale të Sterjo  
Spases, i cili e instrumentalizon të riun *Gjon Zaveri* për t'i

shprehur pikëpamjet e tij filozofike për jetën dhe fenomenet e saj. Mendime të errëta ndaj  
problemeve të jetës dhe pyetje të cilëve nuk u gjinde përgjigje adekuate, si dukuri kanë  
ekzistuar dhe më herët, që në kohët e lashta. Pra, pak janë ata njerëz të cilët meren me „letra”,  
qofshin filozofë, shkrimtarë ose poet që të paktën njëherë në jetën e tyre, nuk e kanë pyetur  
veten se ç'është jeta dhe ç'qëllim ka ajo. Kjo pyetje thelbësore zvaritet gjatë shekujve deri në  
kohën tonë, varësisht nga gjendja ekonomike, sociale, politike e një periudhe të caktuar  
kohore. Prandaj nuk është për t'u habitur kur një filozof si Diogjeni <sup>382</sup> i lashtësisë e mbyll  
veten në fund të verës për të medituar në qetësi.

Në vazhdim të studimit shkencor, si shembuj të orientimit pesimist dhe nihilist, do të  
analizohen dy poet të njohur italian të shekullit të nëntëmbëdhjetë, *Giacomo Leopardi* dhe  
*Guido Gozzano*, të cilët me siguri i ka lexuar dhe admiruar shkrimtari Sterjo Spasse.

*Giacomo Leopardi* <sup>383</sup>- (1797-1837) është njëri nga poetët më të njohur të romantizmit në  
letërsinë italiane dhe nuk është i vetmi që me poezinë e tij ndonjëherë kthehet në një  
melankolik të papërmirësueshëm dhe me një zhgënjim të pakufishëm shpirtëror, si dhe  
paraardhësi i tij, *Ugo Foscolo*. Në vazhdim paraqesim një shembull për melankolinë  
shpirtërore të Giacomo Leopardit:

"Të dashurës"

Vërtet, të lashë me dëshirë,

<sup>381</sup> Giovanni Boccaccio 1313-1375 shkrimtar italian dhe poet. Një humanist i rëndësishëm i renesansës, bashkëkohës i Dantes dhe Petrarkës.

<sup>382</sup> Diogjeni i Sinopës me nofkën „qen” është përfaqësues më i njohur i shkollës cinike, e themeluar nga Antisthënës, njëri nga studentët më të dalluar të Sokratit.

<sup>383</sup> Giacomo Leopardi është liriku më i madh i letërsisë Italiane, pas Dante Alegierit pasi Dante Alegieri, llogaritet si krijuesi më i madh i të gjitha kohrave për popullin Italian.

*Tani u bëj thirrje valëve që psherëtin  
 Duke u përplasur me Alpet, dhe rënkimi im  
 I transmeton erërat e qeta të detit Tirren.  
 Mendova se zemra ime do të shërohej nga mjerimi  
 Ah, shpresë e kotë! Dashuria dhe në mes të ferrit,  
 Ajo është e pavdekshme, e fortë, do të vijë pas meje” (HUGO FOSCOLO, LIRIKA ITALIANE, fq.79).*

Ndjenja e së shkuarës, dashurisë dhe entuziazmit, fillimisht kthehen në një shqetësim të thellë për të.

Si *Hugo Foscolo* ashtu edhe *Giacomo Leopardi* përpiqen të luftojnë romantizmin si burim melankolie dhe apatie (që më vonë e gjithë kjo kthehet në pesimizëm të pashërueshëm), por pa sukses. *Giacomo Leopardi* është një romantik i trazuar në fillimet e karrierës së tij letrare. Për të varri është simbol i realitetit por edhe për të tjerët, që jetuan në kujtimet e tij, personazhe që në kujtesën e poetit kthehen në **simbole të pavdekshme**. Leopardi në skenën letrare paraqitet si një njeri i cili ka një frymëzim të jashtëzakonshëm në shkrimet e tij.

Iluzionet e dashurisë (jo njëlloj si te *Gjon Zaveri*) e *stigmatizojnë* jetën e njeriut si një *fatkeqësi e madhe*, sepse mendime të tilla dhe perceptime të tilla për jetën në tërësi janë pengesa reale për zbatimin e gjërave të bukura thotë *Giacomo Leopardi*. Ai nuk mund të festojë as me iluzionin si një shpresë jete, sepse në kundërshtim, ai edhe atë(iluzionin) e shkatërron. Ai beson se vetëm në rininë e hershme iluzionet i dhurojnë një gëzim të kufizuar njeriut në një kohë të limituar. Pas një vizioni të një realiteti skeptik dhe të ftohtë, ai gjen kënaqësinë shpirtërore në një dhimbje të ëmbël vetëm në kujtimet e së shkuarës, të mbuluar me një shtresë pluhuri, duke i kujtuar ëndërrimet me një nostalgji, fatalitet dhe shpresa të humbura.

Shpresat lidhur me kujtimet e së shkuarës, të cilat në një kohë të caktuar zëvendësohen nga realiteti i hidhur i kohës, janë motive më të rekomanduara të *Leopardit*.

Që të konfirmohet e gjithë kjo mjaftojnë disa vargje nga poezia: „Kujtimet”

„Kujtimet”

*O ju yje të shqetësuar unë nuk e mendoja  
 Të kthehem në shtëpinë e babait tim  
 Ose të të shoh nga kopshti i kësaj shtëpie,  
 Aty ku e kalova fëmijërinë, këtu pashë diçka tjetër  
 Fundin e gëzimit tim  
 Në rininë time të hershme më pushtoi kënaqësia,  
 Më vonë dridhja dhe pikëllimi i së shkuarës  
 Vdekjen e ftova disa herë gjakftohtë dhe për një kohë të gjatë  
 Unë isha ulur aty, afër atij burimi  
 Duke menduar se në atë uj do të jap shpresë,  
 Dhe dhimbjen time.  
 I kaloj vitet e mia këtu, vetëm  
 Pa dashuri dhe jetë...  
 Nga të gjitha anët robëruar nga çdo dashuri dhe karakter,  
 Dhe e urrej botën për shkak të kafshëve që më rrethojnë.  
**Nerina**, vajza më e dëshiruar u zhduk pa lënë gjurmë  
 Ajo kohë sublime u zhduk nga kujtesa ime!  
 Ku je? Nuk mund ta dëgjoj më zërin tënd...  
 (Lirika italiane, Zagreb 1930, fq.93 / 95)*

Pra, pesimizmi ndaj ditëve të humbura të rinisë dhe iluzionet ndaj një vajze për të cilën dashuria qe aq e delirë, por fatkeqësisht e humbur para kohe. Pra, në këto momente del në pah **antipodi** i Gjon Zaverit përsa i përket problemit të ndjenjave dhe një dashurie të vërtetë, e humbur por e pa harruar ndër vite nga poeti i madh.

Një poet tjetër italian, pesimist dhe nihilist ndaj botëkuptimeve filozofike, të cilave i afrohet filozofia e jetës mohuese të Gjon Zaverit, është poeti *Guido Gozzano*.

**Guido Gozzano**<sup>384</sup> (1883-1916) jeton dhe punon në periudhën në mes shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të njëzetë.

Në Itali, pas epokës së Giacomo Leopardit, u shfaq një drejtim letrarë i cili quhej **Crepuscularism** - Crepuscolo - mbrëmje (perëndim i diellit).

Në Francë kjo periudhë letrare në disa raste është quajtur edhe „**Dekadente**” ose zbritje në letërsi, kështu njeriu individualizohet nga ky dekurajim apo depresion shpirtërorë. Individu (fytyra) përfundimisht bëhet motivi qendror në temën e romanit (pasi Gjon Zaveri është figura *qendrore* rreth të cilit rrotullohen njerëzit dhe ngjarjet, ndërsa ai vetë nuk lëviz për të bërë diçka pozitive, por mbetet statik me idetë e tij të palëvizshme dhe shterpe.

Kjo është një formë e distancimit nga shoqëria, nga njerëzit, **vetëizolim** dhe përqaftimi i një jete të vetëmuar.

Distancimi i individit, sidomos i shkrimtarit apo poetit, nga të tjerët u praktikua edhe në kohën e romantizmit. Akoma më mizorisht kjo gjendje ekstreme kulmin e vetë e arriti në **parnasizëm** (vetmi ekstreme). Diçka që i ndodh edhe Gjon Zaverit në fund të romanit: javë të tëra mbyllet në dhomë, nuk pret të dashurit e tij, as nusen me të cilën u martua disa javë më parë: refuzon të hajë, nuk shkruan, futet në gjendje halucinative, bën polemika vetëm me filozofët e tij imagjinare, duke u dobësuar kështu mendërisht dhe fizikisht.

Pra edhe Krepuskolarët janë ata poetë që e adhurojnë vetminë. Poezia apo proza e tyre përqendrohet në ikje, sepse ajo **botë e madhe**, bota e **ngjarjeve të mëdha**, bota e idealeve masive të ekzaltimit, rendi shoqëror i shpresave të mëdha, tani këtyre shkrimtarëve u dukej si një iluzion, si një mashtrim pakufi. Këta njerëz të letërsisë krepuskulare mendojnë se e gjithë bota është e mbuluar me kostum dhe dekor të maskuar dhe veprat letrare që na prezantuan këta poet, nuk ishin gjë tjetër veçse një *iluzion masiv*.

Në lirikën e tij, *Guido Gozzano* mbetet besnik në dy dëshirat e tij të nxehta:

- *Dhimbja e dashurisë së porealizuar dhe vdekja* - dy gjërat më të bukura, më të pranueshme për poetin.

Guido Gozzano merret si shembull për krahasim sepse shprehjet e mendimeve për jetën dhe vdekjen janë pothuajse identike me pikëpamjet e Gjon Zaverit, por me një dallim, në pikëpamjet e dashurisë, pasi Gjoni nuk dëshiron ta diskutojë dhe të veprojë, kur vjen në pyetje çështja e sentimentalizmit. Guido Gozzano është një njeri që e adhuron dashurinë por për fat të keq qëndron shumë larg saj, sepse ka humbur besimin tek njerëzit dhe botën në përgjithësi, një botë pa *besim* dhe *ideale* nuk është një *botë humane*. Vlerat e bukura humbasin për një ideal, për një dëshirë, ajo botë bëhet shkak i shkrirjes dhe mos ekzistencës së dashurisë në çdo aspekt ku ajo shfaqet.

Veprat letrare të pjesës së dytë të shekullit XIX mbizotëruan nga realizmi, por në fund të të njëjtit shekull, veçanërisht nëpërmjet natyralizmit, dolën në sipërfaqe vepra letrare me frymë pesimiste, që kulmuan me një dorëheqje totale. Disa poetë dhe shkrimtarë mendojnë se

<sup>384</sup>Guido Gozzano është i lindur në Turin, babai i tij ishte inxhinjerë i ndërtimit dhe quhej Fausto Gozzano. Guido e kaloi jetën e tij në Turin dhe Aglie, ku famija e tij kishte ndërtuar disa ndërtime në atë pjesë. Letrat e dashurisë që i kishte shkruar për lidhjen e tij me poeten e re Amalia Guglielminetti, u botuan në vitin 1951, pas vdekjes së tij.

mundësitë ideologjike janë shkrirë, të gjitha vlerat e vërteta janë mposhtur, sikur të kemi arritur në fund të një rruge pa drejtim. Pra, vetë fjala *Crepuscolo* ose muzgu, mbrëmja, fundi i ditës, është një shprehje tipike figurative, afrim në fund të jetës, do të thotë afrim i errësirës.

Guido Gozzano si poet do të shqyrtohet më shumë sepse, sipas meje, *pesimizmi* dhe *nihilizmi* i romanit "Pse" të Sterjo Spasses ka ngjashmëri apo afërsi më të madhe. Njohuritë kryesore të Gjon Zaverit përbëhen nga tri pika filozofike gjatë zhvillimit të thurjes së romanit.

Duhet theksuar se Krepuskolarizmi si drejtim letrar nuk është i përqëndruar vetëm në Itali në këtë periudhë. Kjo ndërthurje e errët shkrimi është shumë e pranishme edhe në Francë, ku shkrimtarët më të njohur janë *Arthur Rembo* dhe *Pol Verlen*.

Një shembull nga poezia e Pol Verlenit :

„**ZEMRA IME PO QAN**"

*Nuk ka dridhje më të madhe*

*Kur nuk e dini **Pse-në***

*Pa dashuri dhe urrejtje*

*"Zemra më dhemb shumë".*

Ashtu si këta shkrimtarë të famshëm (të lartpërmendur) gjithashtu edhe Guido Gozzano është gjithmonë i vetmuar dhe shpesh mediton me veten e tij për mendimet e thella të tjerëve, por vetëm në Egon e tij personale.

Një shembull i Guido Gozzanos ku dalin në pah meditimet e tij:

**"Kush studion shumë përballet me çmendurinë!"**

*Ai përdor diturinë për të dobësuar trupin me mundime*

*Një pikë e pastër gjaku ka më shumë vlerë*

*Se të gjitha shkencat e përgjumjes "*

(Kështu mendon edhe Gjon Zaveri, në disa momente kur e pushtojnë ethet e rënda të pesimizmit dhe nihilizmit që janë thelluar në personalitetin e tij, sepse mendimet e tilla janë si helme që i shkaktojnë trurit dhe trupit ngarkesa të kota.)

Shkrimtarët e kësaj periudhe kanë një shpirt të trishtuar i cili hidhërim reflektohet në veprën e tyre letrare.

Kjo është një veçori e poezisë, pjesërisht dhe e prozës në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimet e shekullit të njëzetë, që kulmoi në fatalitet dhe nihilizëm total.

Poeti këtë fatalitet e thekson në disa vargje që vijojnë :

„*Pra, unë ekzistoj!*" *Gjë e mahnitshme!*

*Unë jetoj mes hapësirës dhe **ASGJËSË***

*Kjo krijesë e gjallë*

*e quajtur Guido Gozzano*

*Dhe kush janë njerëzit?*

*Kush janë ata?*

*Një përmbledhje e mahnitshme*

*Mes shumë gjërave të çuditshme.*

*Unë qesh e mbetur vetëm*

*O qiell, o tokë, o det*

*Filloj të dyshoj*

***Jetoj ose nuk jetoj!***"

Pra, hezitim total ndaj botës që e rrethon dhe ndaj vetvetes, pajtohet plotësisht me bindjet e Gjon Zaverit kur bëhet fjalë për *njemendësinë* e ushqyer thellë nga *iluzionet* dhe bota *irracionale*, sepse ky njeri në të njëjtën kohë nuk ka as besim dhe as ideal.

„Gjithçka kam provuar, gjithçka  
Dhe lavdisë së jetës, E MIRA DHE E KEQJA  
Të gjithë më jepnin një makth  
Atdheu! Zoti! Njerëzimi! -Fjalët që paragjyquan folësit më shkaktuan NEVERI!” (POEZI  
ITALIANE, 172)

Nënkuptohet se vargu i strofës më lartë: „**Jetoj ose nuk jetoj**” përputhen plotësisht me një mendim të Gjonit ku thotë :

„O, jetë, o vdekje....

Ose jam ... ose nuk jam " (Pse, 101)

Pra, pikëpamje që përputhen me mendimet e errëta të Gjon Zaverit. Motivi i vetëm në poezinë e Guido Gozzanos është fiksimi i frikës nga gjithçka, nga jeta, nga njerëzit, nga dija e kështu me rradhë. Guido Gozzano ka një dëshirë të zjarrtë për dashurinë, por edhe këtu ka një të metë: “Poeti nuk mund të dashurohet – ndryshe nga Gjoni, që kërkon dashurinë e pastër – dashurinë pa interes.

Vetë natyra e Guido Gozzanos është e mallkuar, e ftohtë dhe në fund armiqësore, e vetmuar. Këtë gjendje shpirtërore, domethënë vetminë e adhuron edhe Gjoni. Guido Gozzano izolohet nga bota dhe prandaj poezia e tij është më së shumti bisedë (shkëmbim mendimesh). Kjo është veçoria themelore e poezisë, pjesërisht dhe e prozës, në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillim të shekullit të njëzetë, e cila periudhë kulmon me pesimizëm dhe nihilizëm.

Pra, hezitimi ndaj botës që e rrethon dhe ndaj vetes, pajtohet plotësisht me bindjet e Guido Gozzanos, pra me mentalitetin e Gjon Zaverit në lidhje me njëmendësinë e ushqyer me iluzione plotësisht. Ky njeri nuk ka asnjë shpresë për mirëqenie dhe gjithçka përfundon në mohim dhe asgjë.

Guido Gozzano ka një ideal shumë të nxehtë dashurie, por për atë të cilën nuk do ta arrijë kurrë dhe atë që nuk do ta gjejë asnjëherë. Sa e sigurtë është kjo dëshirë e poetit!? Poeti nuk mund të dashurohet sepse nuk ka guxim dhe si i tillë gjatë jetës së tij endet si lypës i mallkuar, endet rrugëve të jetës duke shpresuar se një ditë do ta gjejë „dashurinë që nuk kthehet”. Guido Gozzano ka një poezi shumë interesante me të cilën i drejtohet shokut të tij nga rinia me këto fjalë :

"Ah! Sikur të mund të dashurohesha! Ju premtoj se nuk kam dashur deri tani: e kaluara ime ishte një përzierje dashurie. Ky mashtrim më rëndon plotësisht, duke u bërë një maskë e trilluar që më hidhëron shpirtin, një maskë e shpërqëndruar në zemrën time të shuar,

Më është lodhur shpirti

A do të kthehet dashuria, Marta?

Ajo (Marta) përgjigjet:

"Ndoshta!...."

(Lirika Italiane, fq.45)

Kjo dëshirë e madhe poetike - aq e fortë dhe e paarritshme, ishte një mallëngjim për atë që nuk arrihet dhe nuk do të arrihet kurrë.

Ai shpreh gjithmonë një *melankoli* ndaj të gjitha vlerave njerëzore, ndaj vlerave që nuk mund të realizohen në këtë botë të çuditshme dhe të *rrreme*.

Kritiku i madh letrar italian, Benedetto Croce,<sup>385</sup> e vlerëson këtë gjendje shpirtërore të shkrimtarit të madh si më poshtë :

<sup>385</sup> Benedetto Croce 1866-1952 shkrimtar, filozof, historian, dhe politikan Italian.

“Jeta do të ishte më e mirë nëse vlerat e vërteta do të ekzistonin. Me kalimin e shekujve, kur është bërë analiza e vërtetë letrare, kemi arritur në përfundim se vlerat ekzistuese njerëzore janë vetëm iluzione të kota, ato nuk kanë ekzistuar kurrë dhe nuk do të ekzistojnë kurrë” (Lirika italiane, 135).

Pastaj: “Një zonjë e zhveshur pa formë  
Ajo transformon gjithçka kur e prek me gishta”  
(Lirika italiane, 146).

Në këtë mënyrë, pas zhvillimit shekullor të kulturës, ne kemi ardhur në fund të jetës, si një ideal i caktuar”.

Pra, duke ndjekur mendimet filozofike dhe letrare të *Krepuskolarizmit*<sup>386</sup> (ose në Francë të quajtur dekadentizëm) arrijmë në përfundim se ky drejtim letrar (i cili pati një ndikim të dukshëm në vendet e tjera evropiane, por edhe në letërsinë shqipe, i drejtuar nga shkrimtari Sterjo Spasse, në një farë mënyre nuk duhet përjashtuar dhe Migjenin) është shprehje e një filozofie që pranohet si mendim që përcakton prirjen filozofike të kësaj periudhe. Pra, dy vargjet e Guido Gozzanos, “Një grua e zhveshur pa formë transformon gjithçka kur e prek me gishta”, na hedh kujtesën e skenës së trishtë ku përshkruhet “varri pa fund”, ku vendoset Gjon Zaveri me halucinacionet e tij, duke shkelur eshtrat e shumta të të vdekurve. Kjo skenë bëhet edhe më e trishtuar në momentin kur Gjonin papritmas e pret një hije e madhe me shpatë në dorë, shpatë që personifikon vdekjen.

## PËRMBYLLJE

Romani „Pse” i Sterjo Spasses që gjeti dritën e botimit në vitin 1935, llogaritet si roman i parë në letërsinë shqipe i cili veç motivit social që kishte në brendinë e vet, karakterizohej edhe me përmbajtje filozofike. Kështu viti 1935 Shqipërinë, respektivisht letërsinë shqipe, e pasuron me tema me përmbajtje filozofike letrare, e cila si krijimtari buron nga shkrimtari i madh i asaj kohe Sterjo Spasse. Personazhi kryesorë i romanit të Sterjo Spasses posedonte mjaftë tipare të çuditshme dhe specifike, të cilat cilësi unike, mundësuan krahasimin me poet dhe personazhe të letërsive evropjane dhe botërore.

## BIBLIOGRAFIA

- [1]. -Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006
- [2]. -Nizeteo, Delerko. Lirika Italiane. Zagreb: Tiskara Narodnih Novina, 1939
- [3]. -Popoviç, Vladeta. Nëpër letërsinë angleze. Beograd: 1929
- [4]. -Svoboda, Fedor. Guido Gozzano, Krepuskolarizmi në Itali dhe Dekadentizmi në Francë. Zagreb: 1953
- [5]. -Spasse, Sterjo. “Pse” Prishtinë: Rilindja, 1986.

---

<sup>386</sup> Është drejtim letrar, i cili paraqitet si fenomen në Itali në fillimet e shekullit të njëzetë.